



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborní Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 748/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afiete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Fitore Isufi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Bekim Kovani, anëtarë për Kuvendin Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.11.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Bekim Kovani, anëtarë për Kuvendin Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega në Kamenicë, me shenjen ZL.Anr.748/2017, të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017,

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.748/2017 me datën 09.11.2017, nga Bekim Kovani, anëtarë për Kuvendin Komunal në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik NISMA, në të cilën pretendon se Raporti i FRK-së nuk përputhet me raportin e vëzhguesit për antarë të Kuvendit Komunal, në Kamenicë, nga radhët e subjektit politik NISMA, Bekim Kovani me nr. 14, në vendvotimin 1024D/03R në Koretin.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ankuesit gjeti se ankuesi me asnjë provë bindëse nuk ka dëshmuar dhe nuk ka identifikuar se sa vota i mungojnë në vendvotimet në

të cilat pretendon se ka pasur parregullsi. Prandaj Paneli ankesën e ankuesit e konsideron si të përgjithësuara dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësoj kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesë, konstaton se ankesa në fjalë është e pabazuar dhe e pa argumentuar dhe si të tillë ankesën e ankuesit e refuzoj.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr.748/2017 më datën 10.11.2017.

**Kryesuese e Panelit**  
Gyltene Syljmani



***Udhëzim Juridike:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*